

### KRIZA E EPËRME E QYTETIT TË VERIUT

Kaosi i përgjithshëm në të cilin vazhdon të gjendet Shqipëria asht, ndër të tjera, tregues autentik i papërgjegjshmënisë absolute të klasës politike shqiptare, për fatet nacional-demokratike të vendit dhe i gjendjes reale të formimit të ndërgjegjes patriotike dhe qytetare të shtresave të caktueme të shoqnisë sonë. Kriza që po kalojmë, e cila duhet me u konsiderue krejtësisht e shmangshme, në fakt ka kompromentue randë ardhmëninë dhe imazhin e Shqipënisë në botën e qytetnueme. "Kriza e fajdeve" përbante vetëm momentin e epërm të një tranzicioni të vështirë nga një shoqni mikste mesjetaro-komuniste, drejt erës kapitaliste. Kjo krizë sherbeu vetëm si katalizator i kontradiktave dhe disniveleve absurde të shoqnisë shqiptare postkomuniste. Ndër këto plagë të varuna dhe të destinueme me u kapërcye në këtë tranzicion shqiptar të këtij fundmijëvjeçari, ishte edhe ajo dukuri, që në Evropën perëndimore ka ndodhun në kapërcyellin nga Mesjeta në epokën moderne: shpërthimi i natyrshëm demografik postmesjetar. Ajo që ndodhi mbas, kje një lëvizje tipike fshatare vetëshkatërruese, përgjithsisht e vetvetishme, që tronditi randë themelet e shoqnisë dhe shtetit. Megjithatë duhet pranue se kjo krizë ishte e paralajmrueme, mbasi shqiptarët e thjeshtë po vërtetojshin në çdo hap të tyre, rrejshmëninë e ligjit, mosfunksionimin e shtetit dhe administratës së tij, përpjekjet e parreshtuna komuniste për marrjen e pushtetit me forma jodemokratike, mosharmonizimin e interesave midis shtresave të ndryshme të shoqnisë, spontaneitetin në rregullimin e shpërpjestimeve demografike dhe sociale të trashëgueme nga shoqnitë paraardhëse, dhunimin sistematik të qytetarisë dhe të intelektualizmit tradicional shqiptar, kuptimin ma primitiv të ndërtimit të një shteti

dhe të një demokracie, nënvleftësimin total mbi efektshmërinë e sistemit arsimor kombëtar etj.

### *Rozafa e tronditun*

Shkodra, e përfshime në mënyrën më të papritun në këtë krizë, po përjeton sot ndoshta momentet më të vështira të historisë së saj: zhvleftësimin e dhunshëm dhe të pameritue të statuteve dhe kodeve të saj qytetare shumëshekullore, të qenut dhe pambrojtut, të dinjitetit personal, familjar, pasunor dhe intelektual të qytetarisë së saj, masën e popullatës së rajonit në nivelin e urisë, spostimin në plan të dytë të rolit të saj tradicional parësor në skenën shqiptare, tradhtimin e idealit të saj demokratik dhe patriotik, shkatërrimin e pameritue të atyne të mirave materiale që jepnin një lloj shprese për të ardhmen, largimin epidemik të djelmnisë dhe inteligjencës së saj, një perspektivë të mbyllun nga kufizimet politike dhe infrastrukturore; mbi të gjitha, Shkodra rrezikon mos me qenë e përfaqësuar realisht politikisht dhe administrativisht nga tradita, urtësia dhe intelektualizmi i saj. Asnjë nga pushtuesit e huaj që kaluen në këtë truall, nuk e lanë këtë qytet dinjitoz më të pambrojtun se sa "shteti rrëmujë" shqiptar. Kjo ndoshta, jo aq për bujarinë e tyne, sa për imponimin madhështor të qytetarisë dhe të traditës së tij. (Qytetaria nënkupton ushtrimin më të gjanë të të drejtave dhe detyrave nga shtetasi, përgjegjësinë që ato kanë për mbrojtjen dhe fuqizimin e këtyne të drejtave për veten dhe të tjerët, bazuem në sjellje praktike dhe norma edukative dhe demokratike). Shkodra ka reflektuar tradicionalisht sjellje, praktika dhe norma të një kulture demokratike vetëqeverisëse, të cilat kanë qenë imponuese në nivelet e drejtimit të shtetit shqiptar. E keqja sot qëndron se Shkodra po noton e përgjumun në kaosin shqiptar, pa e ditun ku është bregu i përtejme i shpresës dhe mundet me u vendosë spontanisht dhe padrejtësisht në rolin e një lodre të destinuar për me u sakrifikuar nga meskinizmi i politikës. Lejimi i matejme i këtij "udhëtimi" të pashpresë do të thotë rrënim përfundimtar i traditës, qytetarisë dhe fisnikërisë së tij.

Ndërpremja e detyruar e udhës dhe përcaktimi i përshpejtuem i veprimeve shpëtuese, do me thanë ringjallje e shpresës së



meritueme për të.

### *Themelet e Rozafës*

Por cilat janë bazamentet në të cilat Shkodra duhet me u mbështetë? Cilat nga ato vazhdojnë me u mbajtë të forta në zemrat e shkodranëve?

Së pari, populli i Shkodrës karakterizohet në masën e tij të shëndoshë nga një vetëdije uniteti nacional dhe kulturor tashmë të formuem. Shkodrani, në kriteret e tij vlerësuese e përzgjedhëse, ka pasun parasysh gjithmonë interesat nacionale, sepse ai e ka të kurtë se populli i tij asht një dhe i pandamë, dhe se vitaliteti i nacionalizimit të tij qendron tek vetëdijshmëria e plotë mbi tolerancën dhe harmoninë fetare, bashkësinë e përbashkët kulturore iliro-arbnore, të qenunit e saj si bastion i qëndrueshmënisë së papërzier kulturore shqiptare, përgjegjshmëria e përbashkët për ardhmëninë e qytetit në një Shqipëri të vërtetë demokratike dhe dinjitoze në botën e qytetnueme evropiane. Vetëm rindërtimi i një shoqnie të tillë moderne tolerante evropiane, që bazohet kulturalisht në tabanin kombëtar shqiptar, traditën e marrëdhënies normale qytetare, me sisteme të zhvillueme edukimi, telekomunikimi dhe rendi publik normal, do të duhet të përbajnë aspiratën sublime të këtij brezi hallemadh qytetarie. Qytetarët e Shkodrës janë krenarë sot për izolimin civil të veprimtarisë rebeluese që germonte në mjegullën e kaosit shqiptar të marsit 1997. Shkodranët nuk do të harrojnë kurrë veprimin e përgjegjshëm nationalist të klerikëve të të tre komuniteteve dhe të qytetarëve të parë të tyre. Ata shprehen vetëm atë çfarë zemra shkodrane mbante ndrydhun. Kjo do të jetë baza mbi të cilën do të duhet me u mbështetë mendja intelektuale drejtuese e Shkodrës për projektimin e rilindjes së meritume dhe të ardhmes së fëmijve të saj.

Sy dyti, Shkodra mban të pashlyeshme në thelbin e saj kodet e qytetarisë ma të vjetra dhe ma të qëndrueshme shqiptare dhe evropiane. A përban domosdoshmëni venia në efikasitet e këtyne kodeve shekullore në praktikitetin e jetës publike të qytetit? A do të jetë një nder dhe krenari për të gjithë qytetarët e sotëm të Shkodrës pranimi dhe mosdhunimi i këtyne kodeve shekullore

me famë evropiane?

Së treti, Shkodra asht e ndërgjegjshme se asaj i takon realisht roli parësor në skenën shumëplanshe shqiptare. Ky rol, i dhunuem barbarisht gjatë diktaturës komuniste, nuk u rikuperue as në masën fillestare nga përfaqësimi politiko-administrativ i papërputhshëm në periudhën vijuese. Shkodra, kryeqyteti politik, antik dhe mesjetar iliro-shqiptar, kryeqendra e vetëdijes kulturore të kombit, asht edhe sot pjesë e Shqypnisë, kryeqendra e Shqipnisë së Epërme ose Gegënisë, dhe jo një skaj i mbyllun i shtetit shqiptar. Përherë rruga për në Evropë e administruesve të Shqipnisë ka kalue nëpërmjet Shkodrës, trajtimit dhe testimit të saj. Askush nuk po ia përbuz ma shumë qenien potenciale sot, se sa bartësit e mentalitetit primitiv të trashëguem nga komandantët çobanë të zonës së parë operative, të cilët patën instalue mbi këtë qytet skemat e dhunimit, përbuzjes dhe përçmimit diktatorial. Shkodra nuk don ma ta quajnë djepi i kulturës, sepse asht lodhun tashma nga hipokrizia e lajkave. Ajo kërkon me qenë pjesë e integrueme e një shoqnie moderne perëndimore të balancueme, e zhvillueme harmonikisht dhe proporcionalisht drejt. Ajo dëshiron me kapë atë fill të saj in natyror që ia këputën pabesisht dhunuesit.

Shkodra, kritikuesja ma e parë e politikave të gabueme, ka ditun me dallue kjo të deri ku duhet me shkue opozicioni dhe revolta demokratike ndaj padrejtësisë, ka dallue kjo të pacënueshmëninë e shtetit dhe të integritetit të tij, me të drejtën e ndërimit të politikave, dhe ka veçue dhunën e individëve nga demonstrimi i ligjshëm dhe civil (gja të cilën "kontigjenti fshatar jugperëndimor", nën çorientimin e komandantëve marksistë, ligësisë së politikës, segmenteve të krimit jugor, dhe konspiracioneve joshqiptare, nuk e kuptoi dot në muajt shkurt - mars 1997).

Mbi këto bazamente të vetëdijes së tyre, shkodranët mund të rifillojnë rilindjen e qytetit të tyre të dashtun. Asht e kjo të se shkalla e rindërimit do të varet në një masë të konsiderueshme nga vijimësia e riaftësimit të shtetit shqiptar në tanësi, dhe nga interferencat e interesave të ndryshme politike. Megjithatë, shkodranët duhet me rindërtue, tashma, saktë dhe pa gabime pjesën që i takon, në mënyrë që të ndikojnë ndjeshëm mbi tanësinë. Demokracia dhe shteti, në radhë të parë, janë aftësi në organi-



zim, idealizëm dhe përkushtim në ndërtimin e bazamenteve fillestare të tij. Ky rikuperim i shtetit për shkodranët fillon në Shkodër.

### *Që Rozafa të sundojë krenare*

Në Shkodër duhet me u institucionalizue veprimi këshillues qytetar, në të cilin të përfaqësohen realisht mendimi intelektual dhe ekzigjencat e të gjitha shtresave që banojnë sot këtu. Kjo pleqësi intelektuale duhet me ndikue pikësëpari: që kodet tradicionale dhe ligjet e shtetit të funksionojnë nëpërmjet institucioneve të ligjshme, të cilat të jenë në një veprimtari permanente profesioniste, të depolitizueme dhe të balancueme. Një institucionalizim i tillë do të mundësojë përfaqësime të kualifikueme dhe të përshatshme të ekzigjencave popullore dhe do të shmangë uzurpimet e këtyne të drejtave nga deficienca dhe primitivizimi intelektual.

Filozofia moderne e zhvillimit bazohet në krijimin e qeverisjeve të balancueme, dhe në integrimin ekonomik, social dhe kulturor të të gjithë rajoneve në mënyrë të barabartë në një shoqni të hapun. Kjo filozofi e ka bazamentin dhe autorsinë në qytetin e lashtë të Rozafës, ndër mendjet e ndrituna të bijve të këtij dheu, që hodhën bazat e filozofisë kombëtare dhe demokratike. Kjo filozofi nuk mundet me qenë asnjëherë një shpikje e re e "njerëzve çudibërës", të përshtatun rastësisht dhe dinakërisht me të. Rastësorët mund të jenë kopjues të mirë, propagandistë të zellshëm, por në çdo moment ato mbartin rrezikun e të qenunit artificial. Si të tillë, ata rrezikojnë kurdoherë me shfaqë thelbin e tyre të papërshtatshmënisë me joorigjinalitetin, gja që mundet me pasë pasoja të tejzgjatuna në pranimin e Shqipnisë nga Evropa e qytetnueme demokratike.

Në një shoqni që pretendohet me u ba normale dhe demokratike, nuk mundet me pasë trajtime të diferencueme ndaj rajoneve, konsiderime të heshtuna denigruese dhe jokushtetuese ndaj grupeve kulturore, konservime të qëllimshme të elementeve të regresit. Nuk duhet me harrue kurrë se në një shtet demokratik, qeveria përban vetëm një element rregullues që bashkëjeton në kuadrin e një strukture shoqnore, dhe jo thjesht plotësuese epshesh e dëshirash klanore.

## Aktualitet

---


Për ma se 50 vjet u punue që pozicioni kyç, ekonomik, social, kulturor dhe rrugor i Shkodrës dhe hinterlandit veriperëndimor të eliminohej. Edhe sa kohë duhet me pritë ish-kryeqendra e Shqipnisë që t'i kthejnë të drejtën e investimit në të, të pjesës që i takon nga pasunia kombëtare?! A ka të drejtën ky qytet me ia rindërtue pa shpërblim doganat, ndërlidhjet, komunikacionet, shkollat, bibliotekat, muzeumet, arkivat e shkatërrueme sistematikisht gjatë viteve të presionit mbi të?! A asht detyrë e qeverisjes qendrore ndërtimi i domosdoshëm i strukturave të qëndrueshme dhe efikase të rendit publik?! Deri kur zonat e thella me potenciale të jashtëzakonshme njerëzore dhe turistike të këtij hinterlandi do të jenë të arritshme me format e mjetet primitive të komunikimit?! A e meriton ma shumë se askush Mbishkodra zhvillimin e barabartë sasior dhe cilësor të sistemit arsimor dhe infrastrukturor?!

Arsimi shqiptar nuk mundet me durue ma injorimin e plotë, dhe zgjatja e matejshme e këtij kategorizimi për të, do të thotë jetëshkurtësi të lirisë së shqiptarit dhe fuqizim të elementeve destabilizues të shoqnisë sonë.

Në këtë vështrim, asht e domosdoshme që grupi i përfaqësimit politik të Shkodrës të veprojë në mënyrë kompakte për ndërtimin e kushteve të nevojshme për eliminimin e precedentëve destabilizues. Ndërtimi i tyre fillon nëpërmjet konceptimit të një rajoni të integruem ekonomikisht, shoqnisht dhe kulturalisht në një sistem demokratik dhe kapitalist të standarteve evropiane. Kjo shoqni mund ta rinisë jetën e saj vetëm nëpërmjet krijimit të strukturave moderne të komunikimit dhe rendit publik, të cilat do të krijojnë premiset e domosdoshme për ringjalljen ekonomike, zbutjen e shpërpjestimeve sociale e demografike, eliminimin e shpejtë të agresivitetit të injorancës. Shkodra do të ketë të ardhme, vetëm në qoftë se integrohet realisht në atë sistem të emancipuem që e projektuen baballarët e saj.

*Dr. Romeo GURAKUQI*





Ibrahim Kodra, *Nëna Tereze - Nëna universale* (1985)